



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 538/ 2010

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vlastimir Dimic dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur ankesë e cila i drejtohet Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) në lidhje me parregullsi gjate procesit zgjedhor, në seancën e mbajtur më 16.12.2010, mori:

#### **VENDIM**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje LVV

#### **Arsyetim**

Më datë 12.12.2010 në orën 18:15 në fshatin Randobravë të Prizrenit në QV 2027A për shkak të manipulimeve që janë bërë tërë ditën janë bërë 250 votime në shoqëri të njërit. LVV ka qenë e detyruar ti tërheq të gjithë komisionarët prej QV ndërsa komisionarët e subjekteve tjera politike nuk kanë dashur të tërhiqen nga QV. Parashtruesi i ankesës ka përmendur emrat e komisionarëve si të LVV-së Arbnor Guci dhe Laura Çipa të cilët në fillim kanë qenë të penguar të kryejnë punën e komisionarëve duke ndikuar menaxheri i QV Hazer Shala dhe se tërë ditën kanë qenë të kërcënuar dhe nuk i kanë lejuar të mbajnë procesverbal.

Më 13 dhjetor 2010, PZAP-i ka pranuar një ankesë që i ishte dorëzuar nga LVV, duke pretenduar se në QV 2027A ka pasur parregullsi gjatë procesit të votimit.

Ne mbështetje të pretendimeve parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë prove materiale, me propozim që të ndërmerren masat e parapara ligjore. Neni 118 paragrafi 1 i LVP-së, specifikon

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

Nga shkresat e lendes PZAP vlerëson se ankesa e subjektit politik LVV, ka mungesë të provave për t'u bindur se ka pasur parregullsi gjatë votimit si dhe nuk është ofruar asnjë provë si dëshmi bindëse për parregullsinë e pretenduar. Për këto arsye, dhe duke u bazuar në dispozitat e lartpërmendura si dhe në kuptimin e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

. PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa në Prishtinë**

A nr. 538/2010 më datën 16.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit  
Ferit Osmani**

